



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË

**PROJEKTVENDIM**

Nr 131/18/3, Datë 10 . 7 . 2022

**Për miratimin e Planit të Shlyerjes së Detyrimeve të Bashkisë Lezhë**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.26, datë 27.09.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, Kryetari i Bashkisë i paraqet projektin përkatës Këshillit Bashkiak,

**Për të vendosur :**

1. Miratimin e Planit të Shlyerjes së Detyrimeve për vitet 2022-2024, sipas pasqyrave bashkëlidhur këtij projektvendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngakohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI**

**Pjerin Ndreu**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Nr. 13158 / Prot.

Lezhë, më 20 . 7 . 2022

MIRATOHET  
KRYETARI  
Pjerin Ndreu

PLANI SHLYERJES SË STOKUT TË DETYRIMEVE PËR VITET 2022-2024

Shuma e parashikuar për tu likuajduar gjatë viteve 2022-2024						Në lekë
Nr	Bashkia	Detyrimi i mbetur deri me 31.12.2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Diferenca me 31.12.2024
1	Lezhë	273,627,818	119,725,000	61,332,000	55,842,000	36,728,818

DREJTORI I FINANCËS DHE BUXHETIT

Brikena Vuksani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Nr. 13158/2 Prot.

Lezhë, më 20.7. 2022

MIRATOHET  
KRYETARI  
Pjerin Ndreu

PLANI SHLYERJES SË STOKUT TË DETYRIMEVE PËR VITIN 2022  
(Pasi janë zbritur detyrimet me probleme në dokumentacion)

Nr	Bashkia	Shuma e parashikuar për tu likuajduar për vitin 2022		Në lekë
		Detyrimi i mbetur deri me 31.12.2021	Viti 2022	Detyrimet me probleme në dokumentacion
1	Lezhë	273,627,818	131,405,535	142,222,283

DREJTORI I FINANCËS DHE BUXHETIT

Brikena Vuksani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Nr. 1318 Prot

Lezhë, me 20 . 7 .2022

MIRATOHET

KRYETARI

Pjerin Ndreu



## RELACION

### MBI GJENDJEN E SITUATËS FINANCIARE TË BASHKISË DHE MASAT QË DO TË MERREN PËR DALJEN NGA SITUATA E VËSHTIRËSIVE FINANCIARE

Në zbatim të ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë nr.26, datë 27.09.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, ju informojmë lidhur me situatën financiare të bashkisë dhe masat që do të merren për daljen nga vështirësia financiare e saj, si më poshtë:

✍ Bashkia në fund të vitit 2021 ka trashëguar detyrime të prapambetura në vlerën 273,627,818 lekë, ku këto detyrime janë : Të trashëguara para vitit 2015 në shumën 188,297,333 lekë dhe për investimet e vitit 2019 në shumën 85,330,485 lekë. Stoku i detyrimeve të prapambetura sipas zërave ekonomik është: për mallra me vlerë 12,081,307 lekë, për shërbime me vlerë 49,166,775 lekë, për investime me vlerë 85,330,485 lekë, për vendime gjyqësore me vlerë 946,111 lekë dhe për detyrimet e tjera (shpronësime) 126,103,140 lekë.

✍ Referuar të dhënave të detyrimeve prapambetura që janë në vlerën 273,627,818 lekë dhe të ardhurave të veta të bashkisë për vitin 2022 që janë në shumën 1,080,463,000 lekë (të ardhurat vendore me vlerë 740,000,000 lekë dhe transferta e pakushtëzuar me vlerë 340,463,000 lekë) rezulton se detyrimet e prapambetura zënë 25.3% (273,627,818/1,080,463,000) të buxhetit vjetor, ndërsa shuma e detyrimeve të parashikuara për t’u likuiduar në vitin 2022 është në vlerën 119,725,000 lekë ose 11% (119,725,000/1,080,463,000) e buxhetit vjetor.

✍ Në Buxhetin e vitit 2022 janë parashikuar për të likuiduar (shlyer) stokun e detyrimeve të prapambetura në vlerën 119,725,000 lekë ose 43.8 % e detyrimeve gjithsej, ku deri tani janë likuiduar detyrimet në shumën 70,333,961 lekë (investime – 59,581,653 lekë, mallra e shërbime – 10,752,308 lekë) ose 58.7 % e tyre. Duke parë ecurinë e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2022, mendojmë që deri në fund të vitit do të vlerësojmë të gjitha mundësitë financiare për shlyerjen e vlerës së plotë të detyrimeve parashikuar për likuidim.

✍ Në PBA 2022-2024 janë parashikuar të likuidohen këto vlera detyrimesh prapapmbetura sipas



viteve, e konkretisht: në vitin 2022 – 119,725,000 lekë, në vitin 2023 – 61,332,000 lekë dhe në vitin 2024 – 55,842,000 lekë, por duhet t’ju informojë se nga vlera e detyrimeve gjithsej të regjistruara në kontabilitet para vitit 2015, shuma prej 142,222,283 lekë ose 52% e tyre janë detyrime me probleme në dokumentacion ose mungojnë dokumentat justifikues të këtyre detyrimeve. Për këtë mendojmë që brenda këtij viti do t’ju propozojmë që të hiqen këto vlera detyrimi nëpërmjet vendimmarrjes nga ana Juaj. Megjithatë këto vlera detyrimesh do të mbahen në vëmendjen e punës tonë dhe për çdo rast që do të paraqitet dokumentacioni përkatës justifikues nga subjektet e interesura, do të kalohen për vendimmarrje dhe do të përfshihen për shlyerje në buxhetet vjetore.

☞ Referuar të dhënave të sipërcituar rezulton se vlera e mbetur e detyrimeve pasi të hiqet shuma e detyrimeve që nuk kanë dokumenta justifikues, ngelet shuma 131,405,535 lekë, e cila do të shlyhet në vitin 2022 – 119,725,000 lekë dhe në 6 mujorin e parë të vitit 2023 – 11,680,535 lekë.

☞ Për të mundësuar likuidimin e plotë të këtyre detyrimeve të prapambetura dhe për të moskrijuar detyrime të reja, në vazhdim do të marrim këto masa :

- 1-Përmirësimi i punës së strukturave përkatëse për të mundësuar realizimin 100% të të ardhurave të parashikuara në buxhet.
- 2-Brenda muajit shtator 2022 do të bëjmë rishikim të buxhetit - të shpenzimeve buxhetore, në mënyrë që shikohet mundësia e alokimit të fondeve përkatëse për shlyerjen 100% e detyrimeve prapambetura dhe të parashikuara në buxhet.
- 3-Menaxhim më të mirë të aseteve të bashkisë për të mundësuar gjenerim fondesh dhe forcim të financave të bashkisë.

DREJTORI I FINANCËS DHE BUXHETIT

Brikena Vuksani

